

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2021
 ME ZGJEDHJE

Qershor 2021

Ora 10:00

Lënda: Qytetari-Psikologji QZ

VARIANTI A

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë. Çdo përgjigje e shkruar jashtë vijave kufizuese, nuk do të vlerësohet.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	2	3	4	6	7	8	9	10	12	15	19	24
Pikët												
Kërkesa	26	29	30	33	35	36	39	40	41			
Pikët												

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Qytetari

1. Shteti demokratik është rregullues i jetës sociale dhe i marrëdhënieve mes shtetasve. Bazuar në pohimin e mësipërm, kemi të bëjmë me: 1 pikë
- A) vlerë të ligjit.
 B) moral të ligjit.
 C) funksion të ligjit.
 D) burim të ligjit.
2. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, neni 26, pika 3 përcakton se: Gjatë vlefshmërisë së kontratës, punëmarrësi nuk duhet të kryej asnjë punë të paguar nga të tretët, e cila dëmton punëdhënësin ose i bën konkurrencë atij. Në këtë rast çfarë funksioni ka ligji? 1 pikë
- _____
- _____
3. Bazuar në shprehjen e Xhon Stjuart Millit: "Një njeri mund t'u shkaktojë dëm të tjerëve jo vetëm me veprimet, por edhe me mosveprimet e tij dhe në të dyja rastet, ai është përgjegjës për dëmin ndaj tyre". Argumentoni si mund të shkaktojnë dëm qytetarët me veprimet dhe mosveprimet e tyre. 2 pikë
- _____
- _____
- _____
4. Në vitin 1863, Abraham Linkoln e përcaktoi demokracinë si: "Qeverisje e popullit, nga populli, për popullin". Përcaktoni dy nga parimet kushtetuese që burojnë nga kjo thënie: 2 pikë
- a) _____
- b) _____
5. Lexoni situatën: Banorët që jetojnë në breg të një lumi, përdorin në mënyrë abuzive materialet inerte, me të cilat sigurojnë fitime të çastit, por ndërkohë përgatisin rrënimin gradual të tokës ku jetojnë. Cilat të drejta janë në konflikt midis tyre? 1 pikë
- A) E drejta për fitime ekonomike dhe e drejta për mjedis të pastër.
 B) E drejta e punës dhe e drejta për argëtim.
 C) E drejta e brezave të ardhshëm për mjedis të shëndetshëm
 D) E drejta për zhvillim ekonomik dhe natyror.
6. Ligji numër 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", neni 20, pika 1/a përcakton se çdo punëdhënës duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes. Shpjegoni rolin social të shtetit dhe përcaktoni brezin me të cilin lidhet kjo e drejtë. 2 pikë
- _____
- _____
- _____
- _____

7. Risku i sulmeve terroriste rriti masat e sigurisë në aeroporte, për këtë arsye u shtuan kontrolle të imtësishme të udhëtarëve. Argumentoni pse ka rëndësi kufizimi ligjor i të drejtave të njeriut. **2 pikë**

8. Qeveria e nxënësve ka sjellë një konceptim të ri të rolit të nxënësit në shkollë. Shpjegoni dy aspekte të ndikimit të saj në edukimin e të rinjve, si qytetarë të një shoqërie demokratike: **2 pikë**

a) _____

b) _____

9. Shpjegoni se përse personat me nivel të ulët edukimi kanë më shumë probleme shëndetësore? **1 pikë**

10. Shëndeti konsiderohet një e drejtë. Argumentoni pse shëndeti duhet mbrojtur me ligj? **2 pikë**

11. Një nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit, është: **1 pikë**

- A) përdorimi me kriter i burimeve energjitike.
- B) mbishfrytëzimi i resurseve natyrore të vendit.
- C) tregtia me qëllim fitimi të specieve të rrezikuara.
- D) plotësimi pa kursim i nevojave mjedisore të popullsisë.

12. Shpjegoni dy nisma që do të ishin të vlefshme për ruajtjen e mjedisit sipas formulimit: Mendo globalisht, vepro lokalisht. **2 pikë**

1. _____

2. _____

13. Një grua indiane blen në treg këna për të zbukuruar duart, sipas traditës. Faktori që ka ndikuar në sjelljen e konsumatores është ai: **1 pikë**

- A) mjedisor.
- B) individual.
- C) psikologjik.
- D) kulturor.

14. Barazia në procesin e rekrutimit në punë është një e drejtë që lidhet me mungesën e: **1 pikë**

- A) diskriminimit
- B) paragjykimit
- C) përzgjedhjes
- D) klasifikimit

15. Neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: 1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Në rastin e një punëkërkuessi të papunë mund të themi se shteti nuk po e garanton të drejtën për punë? Analizoni përgjigjen. **2 pikë**

16. Tabela e vendosur anës rrugës, që tregon se përpara ka semafor, paralajmëron drejtuesit e automjeteve:

1 pikë

- A) të ruajnë shpejtësinë e mëparshme të lëvizjes në rrugë.
- B) të ngadalësojnë shpejtësinë për të qenë të gatshëm të ndalojnë.
- C) të rrisin shpejtësinë për të kaluar sa më shpejt vendin e semaforit.
- D) t'i japin përparësi lëvizjes së mjeteve të tjera që duan të parakalojnë.

17. Kodi Rrugor përjashton nga e drejta e pajisjes me leje drejtimi personat që janë të prekur rëndë nga sëmundje të diabetit, vlerësuar nga komisioni mjekësor. Me cilin funksion të ligjit lidhet ky parim: **1 pikë**

- A) përcaktimin e normave për veprimet e ndaluara në rrugë
- B) përcaktimin e organizimit të qarkullimit rrugor
- C) përcaktimin e normave të sjelljes në rrugë të përdoruesve
- D) përcaktimin e mënyrës së përgatitjes së drejtuesve të mjeteve

18. Kemi të bëjmë me kufizim të ligjshëm të së drejtës për informim në rastin e:

1 pikë

- A) censurës në media.
- B) sigurisë kombëtare.
- C) informacionit publik.
- D) mos shpjegimit të motivit.

19. Shpjegoni dy nga problemet që mund të shkaktojnë liria pa kushtëzime në media. **2 pikë**

1. _____

2. _____

20. Ligji Nr. 10112, datë 09.04.2009 (rishikuar në 2017), "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", përcakton të drejtat dhe detyrimet e banorëve në komunitet. Një nga këto të drejta është të: **1 pikë**

- A) bëjnë ndryshime të paparashikuara në pjesën e tyre të bashkëpronësisë.
- B) ndalojnë kryerjen e inspektimit dhe riparimit të hapësirave në komunitet.
- C) marrin pjesë në vendimmarrje për administrimin e mjediseve të përbashkëta.
- D) vendosin sipas dëshirës për përdorimin e objekteve të pandashme të pallatit.

21. Në bashkëjetesën me bashkëpronësi, administratori i pallatit ka për detyrë të:

1 pikë

- A) administrojë buxhetin e mirëmbajtjes.
- B) mbledh qiratë e qiradhënësve.
- C) mirëmbajë rrugën publike afër pallatit.
- D) jap leje për punime të brendshme në shtëpi.

Psikologji

22. Psikologjia duke u zhvilluar si shkencë moderne, ka marrë disa drejtime studimi, një nga të cilat është Bihejviorizmi. Dalloni në alternativat e mëposhtme objektin e studimit të kësaj rryme: **1 pikë**

- A) mendimet, dëshirat dhe impulsset e pavetëdijshme.
- B) proceset mendore si kujtesa, arsyetimi, inteligjenca.
- C) sjelljet e jashtme, që mund të vëzhgohen drejtpërsëdrejti.
- D) strukturat biologjike si truri, sistemi nervor dhe hormonal.

23. Në fushën e psikologjisë eksperimentale, një prej degëve të rëndësishme të saj është psikologjia e zhvillimit, e cila merret me: **1 pikë**

- A) çrregullimet emocionale, mendore dhe të sjelljes.
- B) ndikimin e mjedisit urban dhe natyror në sjelljen e njeriut.
- C) ndryshimet mendore, fizike dhe sociale të njeriut gjatë jetës.
- D) problemet e të nxëniet dhe të përshtatjes së nxënësve në shkollë.

24. Ligji Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 20, pika 2 përcakton se shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve social për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor. Vlerësoni rëndësinë e rolit të psikologëve shkollor përmes dy shembujve. **2 pikë**

a) _____

b) _____

25. Gjatë jetës së njeriut, nevojat e tij janë të ndryshme dhe të lidhura midis tyre. Individu përpiqet t'i plotësojë ato, nisur edhe nga renditja e tyre, si nevoja për siguri, nevoja biologjike, për dashuri, vlerësim etj. Cilës teori psikologjike i takon kjo ide: **1 pikë**

- A) teorisë freudiste.
- B) teorisë biologjike.
- C) teorisë humaniste.
- D) teorisë bihejvioriste.

26. Shpesh stresi dhe ankthi i pengojnë njerëzit të kenë shëndet të mirë dhe një jetë cilësore. Tregoni dy hapa, sipas planveprimit tuaj personal, me qëllim përballimin e stresit të krijuar gjatë pandemisë së Covid 19: **2 pikë**

a) _____

b) _____

27. Jeni caktuar në klasë për të prezantuar një detyrë. Kjo situatë ju shkakton stres dhe filloni të bëni planin e prezantimit, përmbajtjen e tij, skicimin e informacionit që do prezantoni etj. Strategjia që po përdorni në këtë rast për ta përballuar stresin është: **1 pikë**

- A) strategji e fokusuar te emocioni.
- B) strategji e bazuar te mbështetja e të tjerëve.
- C) strategji e fokusuar te problemi.
- D) strategji që lidhet me mirëqënien tuaj.

28. Sistemi nervor periferik përbëhet nga një rrjet shumë i fuqishëm nervash, që lidhin sistemin nervor qendror me të gjithë trupin. Pjesë e tij është sistemi nervor parasimpatik, i cili përgjigjet për: **1 pikë**

- A) njohjen, kontrollin dhe orientimin e impulseve në mjedis.
- B) mobilizimin automatik të trupit, duke e përgatitur për aksion.
- C) stabilizimin e organizmit dhe rikthimin e tij në gjendje normale.
- D) drejtimin e lëvizjeve të vullnetshme të pjesëve të ndryshme të trupit.

29. Sipas psikologut Mazllou, nevojat e njeriut janë hierarkike dhe motivojnë sjelljen e tij. Shpjegoni kërkesat e individëve, që qëndrojnë në dy ndarjet e sipërme të majës së piramidës: **2 pikë**

a) _____

b) _____

30. Emocionet janë tipar i përgjithshëm njerëzor, por mënyra e shprehjes së tyre ndryshon sipas individëve dhe kulturave. Shpjegoni ndikimin e dy aspekteve të mëposhtme, në sjelljen emocionale: **2 pikë**

a) Faktori biologjik _____

b) Modeli kulturor _____

31. Sipas psikologut të njohur Erik Erikson, zhvillimi psikologjik i fëmijëve kalon disa stadi. Në varësi të sjelljes së të rriturve ndaj tyre, në stadin e parë (0 deri 1 vjeç), ata mund të zhvillojnë tipare të: **1 pikë**

- A) iniciativës ose fajit.
- B) zellit ose inferioritetit.
- C) autonomisë ose turpit.
- D) besimit ose mosbesimit.

32. Studiuesit, moshën e adoleshencës, e konsiderojnë si periudhën gjatë së cilës të rinjtë përpiqen të formojnë identitetin e tyre. Për këtë arsye, sjellja e tyre është *më shpesh* në përshtatje me: **1 pikë**

- A) normat dhe kërkesat e shoqërisë.
- B) rregullat e vendosura nga të tjerët.
- C) lirinë dhe parimet personale të tyre.
- D) pritshmëritë që të rriturit kanë për ta.

33. Sipas psikologut Kohlberg, një nxënës i shkollës fillore, në cilin stad të zhvillimit moral është? Shpjegoni pse. **2 pikë**

34. Ilira sheh në televizor një numër telefoni, përmes të cilit mund të kontaktojë me një agjenci udhëtimesh. Ajo nxiton ta regjistrojë në celularin e saj, por ndërkohë e përsërit me zë, që të mos e harrojë. Cilën lloj kujtese po përdor ajo?

1 pikë

- A) shqisore
- B) afatgjatë
- C) retrograde
- D) afatshkurtër

35. Të mësuarit pëmes proceseve konjitive lidhet me aktivizimin e disa aftësive mendore për të njohur, kuptuar dhe parashikuar. Rendisni tre nga format e të mësuarit kognitiv:

2 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

36. Kujtesa është një veprimtari mendore komplekse, e domosdoshme për funksionimin normal të njeriut. Tregoni dy metoda që ndihmojnë të mbahet mend më mirë informacioni i duhur:

2 pikë

- a) _____
- _____
- b) _____
- _____

37. Psikologët flasin për sjellje jonormale, kur ajo ka disa karakteristika, si më poshtë:

1 pikë

- A) është tipike dhe me karakteristika të përgjithshme.
- B) duket normale dhe e pranueshme për shoqërinë.
- C) përshtatet dhe ka natyrë pozitive për të tjerët.
- D) shkakton mjerim dhe vuajtje për të gjithë.

38. Çrregullimet psikologjike dhe sjellore kërkojnë ndihmë profesionale. Një nga këto trajtime është ai psikanalitik, i cili bazohet në metodat e:

1 pikë

- A) hipnozës, analizës së ëndrrave dhe asosacioneve të lira.
- B) terapi në grup, për të përmirësuar raportet ndërpersonale.
- C) shpërblimit ose ndëshkimit, për të mësuar sjellje të caktuara.
- D) krijimit të marrëdhënieve dhe mjediseve të përshtatshme sociale.

39. Nevoja për të njohur dhe shpjeguar sjelljen njerëzore i ka shtyrë psikologët të përdorin metoda të ndryshme për vlerësimin e personalitetit. Përshkruani dy prej tyre, si më poshtë:

2 pikë

- a) Vëzhgimi i individit _____
- _____
- b) Testet projektive _____
- _____

40. Në jetën e përditshme, shumë njerëz heqin dorë nga dëshirat dhe zgjedhjet e tyre kur e shikojnë se janë në kundërshtim me veprimet e të tjerëve. Bazuar edhe në përvojat personale, analizoni dy shkaqet e mëposhtme, që ndikojnë në sjelljen konformiste: **2 pikë**

a) Presioni i shoqërisë

b) Mungesa e iniciativës dhe vetëbesimit

41. Një nga aspektet e jetës shoqërore, ku shfaqet pabarazia gjinore është pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe vendimmarrje. Vlerësoni dy nga faktorët, që ndikojnë në krijimin e këtij paragjykimi: **2 pikë**

a) _____

b) _____
